

**EDUART CAKA**

**DISA TË DHËNA MBI ROLIN DHE TË DREJTAT E GRUAS  
NË SHQIPËRI GJATË SHEKUJVE XVII-XVIII**

**Hyrje**

Gruaja dhe roli i saj në jetën familjare e atë shoqërore ka qenë vazhdimisht objekt diskutimi e hulumtimi. Por, duhet theksuar fakti që studimet e kryera në lidhje me këtë fushë kanë qenë relativisht të pakta.<sup>1</sup> Pra, mund të thuhet se me studimet e deritanishme është e pamundur të përcaktohet pozicioni i saktë i gruas dhe kontributit të saj në historinë e njerëzimit. Nga ana tjetër duhet theksuar se në dekadat e fundit vihet re një rritje në hulumtimet për të drejtat e gruas dhe sfidat me të cilat ajo përballet në kohët moderne. Sot, me zhvillimin e disiplinave dhe metodologjive të ndryshme shkencore dhe me shtimin e literaturës në lidhje me këtë çështje, mund të thuhet se studiuesit e kanë më të lehtë të arrijnë në disa përfundime mbi këtë temë të rëndësishme.

Për sa i përket trajtimit të gruas në librat e historisë, mund të thuhet se kjo mund të ndahet në disa kategori. Në të parën bëjnë pjesë gratë e shtresës së lartë si mbretëresha, princesha, zonja aristokrate etj., jeta e të cilave është më e dokumentuar. Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë gratë e thjeshta, thënë ndryshe shtresa e mesme, të cilat ishin pjesë e jetës së përgjithshme e që kontribuonin kryesisht në familje me rritjen e fëmijëve dhe punët e tjera të shtëpisë. Një kategori tjetër ishin edhe skllavet, shërbëtoret apo robëreshat e zëna në luftëra. Gjithashtu, duke patur parasysh faktin se shoqëritë mesjetare ishin të natyrës teokratike, mund të veçohet edhe një kategori tjetër e grave të cilat ishin murgësja apo ishin të angazhuara me jetën monastike dhe të fesë. Duke u nisur nga

---

<sup>1</sup> Në parathënien e librit prej pesë vëllimesh me titull *Historia e Grave*, një punim i rëndësishëm që trajton historinë e gruas nga antikiteti deri në ditët e sotme, dy editorët e studimit Georges Duby dhe Michelle Perrot shprehen se “gratë, për një kohë të gjatë janë lënë prapa historisë”. Për më shumë shih: *Kadınların Tarihi*, ed. Georges Duby ve Michelle Perrot, C. II, Çev. Ahmet Fethi, İstanbul: Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları, 2005, f.7; gjithashtu shih: Stephen J. Harris, “Introduction”, *Misconceptions About the Middle Ages*, ed. Stephen J. Harris and Bryon L. Grigsby, New York: Routledge, 2008, f. 4.

kategoritë e sipërcituara duket qartësisht se pjesa e grave që kalojnë në faqet e historisë janë kryesisht ato të kategorisë së parë, pra ato gra që kishin patur “fatin” të ishin pjesë e shtresës së aristokracisë.

Zhvillimet e rëndësishme siç ishin rënia e perandorive, luftërat e pushtimet dhe dalja në pah e regjimeve të reja kanë ndikuar drejtpërdrejt në organizimin dhe funksionimin e shoqërisë, të familjes si bërthamë e saj dhe gruas si element bazik i familjes dhe shoqërisë në tërësi. Për këtë arsye pozita e gruas, roli dhe rëndësia e saj në shoqëritë e ndryshme duhet trajtuar sipas periudhës kohore dhe kontekstit kulturor. Në këtë kontekst, edhe studimi i jetës dhe problemeve të gruas në Shqipëri gjatë shek. XVII-XVIII duhet parë në prizmin e gjendjes së saj para pushtimit osman në periudhën në fjalë. Kështu do të bëhet e mundur të pasqyrohet në mënyrë më të plotë gjendja e gruas shqiptare gjatë periudhës së sipërcituar.

*a. Gjendja e gruas në Europë dhe Shqipëri  
para periudhës osmane*

Një ndër problemet më të mëdha me të cilat përballet historiografia shqiptare është mungesa e studimeve për periudhën paraosmane, sidomos për mënyrën e jetesës e jetën brenda familjes shqiptare të kohës.<sup>2</sup> Veçanërisht në lidhje me shekujt e Mesjetës së Hershme, të cilat përkojnë me periudhën bizantine vërehet një mungesë e konsiderueshme e literaturës së nevojshme. Për këtë arsye, punimet që studiuesit kanë në dispozicion janë të pamjaftueshme për të nxjerrë një tablo të përgjithshme të trojeve shqiptare të asaj kohe, si pasojë edhe për të evidentuar pozitën e gruas në shoqërinë shqiptare gjatë periudhës në fjalë. Duke patur parasysh pozitën gjeografike dhe elementin kulturor të saj, mund të thuhet se një vrojtim i përgjithshëm i situatës së gruas në gjeografinë përreth saj si në lindje ashtu edhe në perëndim, do të përbëjë një ide të qartë për të kuptuar edhe gjendjen e saj në Shqipëri.

Nga studimet e bëra në lidhje me temën në fjalë vërejmë se gjatë periudhës së Mesjetës, si në pjesën bizantine ashtu edhe në vende të ndryshme të Europës (deri në shek. XII) gruaja kishte të drejta dhe ishte e përfshirë në jetën shoqërore e drejtuese deri në rangun e mbretëreshës apo

---

<sup>2</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, vëll. I, Tiranë: Toena, 2002, f. 340.

perandoreshës.<sup>3</sup> Në lidhje me periudhën në fjalë, studiuesit flasin për gra të shumta të cilat zotëronin prona, vendosnin taksa, madje shtypnin edhe para.<sup>4</sup> Natyrisht, që këto privilegje ishin të vlefshme për gratë e shtresës së lartë. Ndërsa në lidhje me profesionet që shumica e grave kryenin gjatë kësaj periudhe, mund të thuhet se ato ishin të angazhuara me punë të thjeshta si mjeljen e bagëtive, tjerren e leshit dhe aspekte të tjera në lidhje me veshmbathjen, përgatitjen e birrës apo punë të ngjashme të shtëpisë.<sup>5</sup> Por, kemi edhe raste ku në metropole gratë figurojnë si të punësuarat nëpër korporata. Për shembull, në shek. XIV gratë nga qyteti por edhe nga fshatrat e Firences janë punësuar në punishte leshi.<sup>6</sup> Një element tjetër që duhet theksuar në lidhje me gruan gjatë kësaj periudhe janë edhe ato gra të cilat bënë pjesë në kuvende, pra merreshin me klerin.<sup>7</sup> Studimet e bëra në lidhje me periudhën tregojnë se kishte një numër të konsiderueshëm grash të cilat ishin të përfshira në jetën monastike (kuvendore). Janë të shumta shembujt e grave të cilat në një periudhë të jetës kanë vendosur të bëjnë jetë askete dhe janë bërë pjesë e kuvendeve. Por, duke nisur nga shek. XII-XIII, vendime të ndryshme të dala brenda kishës do të sjellin ndryshime edhe për këtë kategori grash.

Po ashtu, edhe në Perandorinë Bizantine janë të shumta gratë që kishin funksione drejtuese dhe ato që merreshin me dije apo dhe

<sup>3</sup> Veçanërisht në periudhën bizantine hasen shumë gra të fuqishme në postet drejtuese të mbretëreshës apo perandoreshës. Një shembull është edhe nëna e Aleksit I Komnenit. Shih: John S. Rosser, *Historical Dictionary of Byzantium*, Scarecrow Press, 2001, f. 109.

<sup>4</sup> Për shembull kryemurgesha e manastirit Jouarre në Francë, Ermentrud, gëzonte të drejtën e shtypjes së parave. Shih: Suzanne Fonay Wemple, "Beşinci Yüzyıldan Onuncu Yüzyıla Kadınlar", *Kadınların Tarihi*, ed. Georges Duby ve Michelle Perrot, C. II, Çev. Ahmet Fethi, İstanbul: Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları, 2005, f. 186; Andree Michel, *Feminizm*, Çev. Şirin Tekeli, İstanbul: İletişim Yayınları, 1992, f. 34.

<sup>5</sup> Roberto S. Lopez, *Lindja e Europës: Historia e epokës mesjetare*, përkthyer nga Kujtim Ymeri, Tiranë: Dituria, 2012, f. 344.; Dana Carleton Munro, Raymond James Sontag, *The Middle Ages 395-1500*, New York: The Century Co., 1928, f. 27-28; Henri Pirenne, *Ortaçağ Avrupasının Ekonomik ve Sosyal Tarihi*, Çev. Uygur Kocabaşoğlu, İstanbul: İletişim Yay., 2005, f. 55.

<sup>6</sup> D. Munro and R. Sontag, *The Middle Ages...*, f. 29.; H. Pirenne, *Ortaçağ Avrupası...*, f. 232.

<sup>7</sup> George Holmes, *The Latter Middle Ages 1272-1485*, Thomas Nelson and Sons Ltd., Edinburgh: 1962, f. 41; Gary Macy, *The Hidden History of Women's Ordination Female Clergy in the Medieval West*, Oxford University Press, Oxford: 2007, f. 23-24.; D. Munro and R. Sontag, *The Middle Ages...*, f. 25-26.

angazhime të tjera të jetës shoqërore. Një shembull të mirë në këtë rast përbën perandoresha Irena, e cila përkundër traditës e cila nuk e lejonte që një femër të sundonte e vetme, sundoi perandorinë në vitet 797-802.<sup>8</sup> Po ashtu, një grua tjetër me peshë e kësaj kohe mund të cilësohet edhe princesha Ana Komnena (1083-1153), e cila nga studiuesit cilësohet si historiania e parë bizantine. Ajo, ka shkruar një libër të quajtur *Aleksiad* (Alexiad) të cilin ia kishte atribuar të atit Aleksit I Komnenit.<sup>9</sup> Natyrisht që ky fakt vlen për gratë e shtresës së lartë numri i të cilave është jo i vogël dhe që patën ndikime të rëndësishme në zhvillimin e kulturës dhe dijës në Perandorinë Bizantine.<sup>10</sup> Por, studimet e bëra tregojnë që kishte edhe gra të cilat nuk u përkisnin shtresave aristokrate dhe që kishin influencën e tyre jashtë shtëpisë ku figurojnë si menaxhuese dyqanesh, punonjëse në spitale, sipërmarrëse në tregti dhe pjesëmarrëse në aktivitete të ndryshme ekonomike të jetës shoqërore të kohës.<sup>11</sup> Ndërsa pjesa tjetër dhe më e madhe e femrave të kësaj periudhe përballej me probleme të shumta duke u nisur nga martesat në moshë shumë të vogël, puna e krahut, jeta e vështirë familjare dhe probleme të tjera të ngjashme.

Gjithashtu duhet theksuar fakti se të drejtat që grujat posedonte në këtë periudhë varionin edhe sipas kontekstit kulturor, kodit moral dhe përkatësisë fetare të vendit në të cilin ajo jetonte. Për shembull, gjatë sundimit norman të Sicilisë vihet re se sipas ligjit lombard, një grua nuk

<sup>8</sup> J. Rosser, *Historical Dictionary...*, f. 205-206.

<sup>9</sup> Jean Flori, "Knightly Society", *The New Cambridge Medieval History*, Ed. David Luscombe and Jonathan Riley-Smith, vol. IV, Cambridge University Press, Cambridge: 2008, f. 173; Averil Cameron, *The Byzantines*, Blackwell Publishing, Oxford: 2006, f. 45; Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, Shtëpia Botuese Pegi, Tiranë: 2006, f. 14; A. Michel, *Feminizm...*, f. 36; J. Rosser, *Historical Dictionary...*, f. 234.

<sup>10</sup> Një shembull tjetër i pasurisë dhe influencës së grave në periudhën bizantine është dhe Danielida nga Peloponezi, Protektoria e Vasilit I. Në dokumenta pasuria e saj përshkruhet kështu: "Kjo grua kishte me mijëra skllëvër, kopera të panumërta bagitëshë, punishte ku gratë endnin për të stofa madhështore të mëndafshta, qilima shumë të bukur, pëlhura çuditërisht të holla... E saj ishte pjesë e madhe e Peloponezit, dhe, pas shprehjes së një historiku, ajo në realitet ishte "mbretëresha e këtij vëndi!"... Duke lënë mënjatë të hollat, gjërat e çmuara, enët me vleftë të madhe dhe mijëra skllëvër- nga këta perandori ka liruar trimijë dhe i ka dërguar si kolonë në Italinë e jugut- ay ka trashëguar nga kjo grua lart nga 80 çifligje". Shih edhe: *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-II-13, *Mbledhja e dokumenteve të historisë shoqërore-ekonomike të bizantit*, Akademia e Shkencave të B. R. S. S., Përkth. Mirash Ivanaj, Moskë: 1951, f. 41-42.

<sup>11</sup> A. Cameron, *The Byzantines*, f. 123; J. Rosser, *Historical Dictionary...*, f. 264.

mund të ndërmerre një nismë ligjore pa qenë e shoqëruar nga një mashkull. Ndërsa gratë e po të njëjtës gjeografi që jetonin nën ligjin roman ishin të lira të vepronin pa patur nevojë për praninë e një burri.<sup>12</sup> Duke parë shembujt e mësipërm vihet re që jeta e femrës gjatë Mesjetës së Hershme karakterizohej nga një larmishmëri, ku ajo përveç jetës së lodhshme që kishte herë herë na del me angazhime, që krahasuar me kohën, mund të quhen si arritje.

Duke nisur që nga shek. XII vërehet dalja e problemeve të reja në vende të ndryshme të Europës dhe në pjesën bizantine të cilat do të influencojnë edhe në jetën e gruas në përgjithësi. Nisja e fushatave të kryqëzatave, reforma gregoriane<sup>13</sup>, inkuizicioni, “gjuetia e shtrigave”<sup>14</sup> e zgjerimi i mbretërive islame deri në muret e Konstandinopojës dhe probleme të tjera me karakter politik e fetar, do ta tkurrnin rolin e gruas në shoqëri dhe të drejtat e saj në përgjithësi. Studimet e kryera në lidhje me periudhën në fjalë shkruajnë për vajza që martoheshin që në moshën dymbëdhjetë vjeçare, që rriheshin nga bashkëshortët e që ishin të privuara nga shumë liri e të drejta. Historianët shprehen se gjatë Mesjetës, jeta e gruas ishte e vështirë edhe për burrat.<sup>15</sup>

Për sa i përket gruas shqiptare të periudhës së Mesjetës, mund të thuhet se ka shumë pak të dhëna në lidhje me jetën, pozitën dhe

<sup>12</sup> G. A. Loud, “Norman Sicily in the Twelfth Century”, *The New Cambridge Medieval History*, Ed. David Luscombe and Jonathan Riley-Smith, vol. IV, Cambridge: Cambridge University Press, 2008, f. 471.

<sup>13</sup> R. G. D. Laffan (Ed.), *Select Documents of European History 800-1492*, New York: Henry Holt and Company, 1929, f. 36-37; G. A. Loud, “Southern Italy in the Eleventh Century”, *The New Cambridge Medieval History*, Ed. David Luscombe and Jonathan Riley-Smith, vol. IV, Cambridge: Cambridge University Press, 2008, f. 99; G. Macy, *The Hidden History...*, f. 112.

<sup>14</sup> “Gjuetia e shtrigave” është një fenomen i periudhës së Mesjetës, e cila është bazuar mbi elementin e magjisë. Procesi i përndjekjeve dhe “gjuetisë së shtrigave” ka nisur gjatë viteve 1430 dhe ka arritur kulmin në vitet 1560-1650. Por rastet e para të gjykimeve hasen që në vitet 1300. Studimet tregojnë që midis viteve 1500-1700 janë evidentuar mbi 90.000 raste të gjyqeve nga të cilat 45.000 kanë përfunduar me ekzekutime. Sipas statistikave gjatë viteve 1300-1399, 50% e të përndjekurve ishin gra; në vitet 1400-1499 numri i tyre shkon 66% dhe; pas viteve 1500, mbi 75% e të ekzekutuarve ishin femra. Për më shumë të dhëna mbi fenomenin e “gjuetisë së shtrigave” dhe përndjekjet e ekzekutimet e tyre shih: Anita Obermeier, “Witches and the Myth of the Medieval Burning Times”, *Misconceptions About the Middle Ages*, ed. Stephen J. Harris and Bryon L. Grigsby, New York: Routledge, 2008, f. 220-225.

<sup>15</sup> R. Lopez, *Lindja e Europës...*, f. 344.

aktivitetin e saj si në familje ashtu edhe në shoqëri.<sup>16</sup> Në një shoqëri e cila karakterizohet nga luftëra të vazhdueshme, fushëveprimi i gruas por edhe të dhënat në lidhje me jetën e saj janë shumë të pakta. Në lidhje me jetën dhe aktivitetin e grave gjatë kësaj periudhe në trojet shqiptare, vlen të theksohet se ato ishin të angazhuara me jetën familjare, kryesisht me rritjen e fëmijëve, punët e shtëpisë dhe punimin e paktë të tokave me të cilën merreshin familjet në kohë paqeje. Gjithashtu, studimet e ndryshme tregojnë që gratë kanë qenë aktive edhe në luftimet e kryengritjet e zhvilluara kundër osmanëve.<sup>17</sup>

Gjatë periudhës në fjalë, të dhënat flasin kryesisht për atë pjesë të grave të cilat ishin anëtare të familjeve aristokrate, por edhe në poste drejtuese. Këtu, spikasin emrat e Komnena Balsha, Helena Topia etj. Vërejmë se janë lidhur krushqi midis familjeve të pasura, një fenomen i përhapur edhe në hapësirën shqiptare si pasojë e së cilës do të formohen aleanca ushtarako-politike që për kohën rezultojnë shumë të rëndësishme në kuadrin e forcimit dhe konsolidimit të principatave shqiptare.<sup>18</sup> Në këtë kontekst, mund të përmenden disa shembuj si martesat e vëllait të vogël të Gjergj Arianitit, Vladanit me vajzën e Gjon Kastriotit Angjelinën<sup>19</sup>, Gjergj Balsha u martua me vajzën e Andrea Muzakës, Marien,<sup>20</sup> djali i Lekë Dukagjinit, Progoni ishte martuar me vajzën e Karl

<sup>16</sup> Më konkretisht, në historiografinë shqiptare është shumë i vogël numri i studimeve mbi gruan. Përveç disa artikujve shkencorë të botuara kryesisht gjatë periudhës para viteve 90-të në revista të ndryshme i vetmi punim i plotë që vlen të theksohet në kuadrin e punimeve në lidhje me gruan në Shqipëri është libri *Gruaja në Shqipëri (1912-1939)* i prof. dr. Fatmira Musaj, i botuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Për më shumë të dhëna në lidhje me studimet e kryera në Shqipëri për gruan shih: Fatmira Musaj, *Gruaja në Shqipëri (1912-1939)* botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 2002.

<sup>17</sup> Andromaqi Gjergji, “Kontributi i grave në qëndresën e popullit Shqiptar kundër pushtesve osmanë”, *Studime Historike*, nr. 1, Tiranë: 1968, f. 106; Veçanërisht në pjesën veriore të shqipërisë fenomeni i luftimit të grave apo vajzave ishte më i përhapur. Në lidhje me këtë, Zamputi shprehet kështu: “*Të mos harrohet se, pikërisht për nevojat e luftës, në Kelmend (por ndoshta edhe te malësorët e tjerë të asaj kohe) vajzat rriteshin e merrnin pjesë ndër luftime njëjloj si djemtë, i prenin flokët dhe visheshin si ata, përdornin armët si ata, deri në moshën 25 vjeçare, pastaj vinte radha për martesat e tyre*”. Shih. Injac Zamputi, *Shqipëria Veriore dhe Veri-Lindore në dy dhjetëvjeçarët e parë të shek. XVIII, AIH, A-II-108*, Tiranë: 1987-1988, f. 52.

<sup>18</sup> Kristo Frashëri, *Skënderbeu: Jeta dhe vepra (1405-1468)*, Tiranë: Botimet Toena, 2002, f. 31.

<sup>19</sup> *Historia e popullit...*, f. 298.

<sup>20</sup> K. Frashëri, *Skënderbeu...*, f. 31.

Topisë Vojsllavën, ndërsa vajza e tij Boksa, u martua me zotin e Dejës, Kojë Zaharinë.<sup>21</sup> Vet Skënderbeu ishte martuar me vajzën e Gjergj Arianitit, Donikën, ndërsa motrën e vetë Mamicën e kishte martuar me Muzak Topinë.<sup>22</sup> Një rast tipik i martesës për të forcuar pozitat ishte dhe ajo e Andre Topisë me një princeshë nga anzhuinët e Napolit.<sup>23</sup>

Ligjet dokësore të mbledhura nga Shtjefën Gjeçovi në një libër me emrin *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, ose Kanuni i Maleve<sup>24</sup> mbetet një vepër shumë e rëndësishme si për përmbajtjen e saj, ashtu edhe për faktin se ky kanun është një pasqyrë e funksionimit dhe përbërjes së shoqërisë së kohës në pjesën veriore të Shqipërisë.<sup>25</sup> Në këtë kushtetutë të kohës, studiuesit mund të gjejnë të dhëna të hollësishme se si duhet të ndërtohet familja, bashkësia fetare e klerikët në veçanti dhe shoqëria në tërësinë e saj duke përcaktuar përpikmërisht cilat janë të drejtat që secili individ posedon sipas kanunit. Në këtë pikë, vlen të theksohet fakti se shteti osman u njihte pakicave të drejtën e organizimit në komunitet ashtu edhe në çështjet që kishin të bënin me familjen. Kështu, organizimi i shoqërisë dhe familjes në pjesën veriore të trojeve shqiptare të kohës ka funksionuar në bazë të kanunit. Këto janë të dhëna të rëndësishme për të kuptuar parimet dhe rregullat mbi të cilat ishte organizuar dhe funksiononte shoqëria e kohës.<sup>26</sup> Duke patur parasysh faktin që në çështjet civile e fetare shteti osman u njihte të drejta komuniteteve fetare, mund të thuhet se në këto aspekte kanuni ka vijuar të respektohet edhe gjatë periudhës osmane. Në veprën në fjalë gjenden edhe pika që i referohen gruas në veçanti dhe të drejtave të saj në etapa të ndryshme të jetës si familja, martesja, trashëgimia etj. Në fakt, këto përbëjnë dhe të dhënat e vetme në lidhje me jetën dhe të drejtat e gruas shqiptare gjatë kësaj periudhe.

Duke patur parasysh karakterin patriarkal të shoqërisë së periudhës në fjalë, mund të thuhet se vendi i vetëm në të cilën gruaja jetonte dhe

<sup>21</sup> *Historia e popullit...*, f. 311.

<sup>22</sup> K. Frashëri, *Skënderbeu...*, f. 253; *Historia e popullit...*, f. 426.

<sup>23</sup> *Historia e popullit...*, f. 333.

<sup>24</sup> Franc Nopça, *Fiset e malësisë së Shqipërisë veriore dhe e drejta zakonore e tyre*, Përkthyer nga Mihallaq Zallari, Tiranë: Botimet Eneas, 2013, f. 292; F. Musaj, *Gruaja...*, f. 24.

<sup>25</sup> Injac Zamputi, "Pozita shoqërore e gruas malësore shqiptare sipas kanunit", *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria Shkencat Shoqërore*, Nr. 2, Tiranë: 1961, f. 101.

<sup>26</sup> I. Zamputi, "Pozita shoqërore...", f. 102; F. Nopça, *Fiset e malësisë...*, f. 292.

ushtronte aktivitetin e saj ishte ambienti familjar. Ky element, është pasqyruar në mënyrë të qartë dhe të detajuar edhe në kanun. Aty janë cilësuar të gjitha detyrat që ka gruaja brenda në shtëpi si në respektin ndaj burrit, ndaj pjesëtarëve të tjerë të familjes, në rritjen dhe edukimin e fëmijëve etj. Konkretisht, punët e gruas në familje konsistojnë në dy prizma: punët jashtë shtëpisë me karakter prodhimtarie në ara ose vreshta dhe e dyta ka të bëjë me detyrat e saj brenda shtëpisë.<sup>27</sup> Punët që zonja e shtëpisë, por edhe ndihmëset e saj duhet të kryejnë janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar. Duhet theksuar që zonja e shtëpisë ka një pozitë më të rëndësishme se gratë e tjera, të cilat përveç burrit i nënshtrohen edhe asaj.<sup>28</sup>

Ndërsa, në lidhje me vendimin për fejesë apo martesë, kanuni thekson që vajza nuk ka të drejtë preference ose zgjedhje në rastin e martesës. Nopça shprehet se në malësi, e cila funksiononte në bazë të kanunit nuk kërkohet pëlqimi i vajzës për aktin e fejesës apo të martesës. Madje ky akt shikohej dhe konsiderohej në formën e një kontratë blerjeje.<sup>29</sup> Ndërsa në kanun, elementi i martesës pa u marrë parasysh vullneti i vajzës është theksuar në këtë mënyrë: *“Vajza, edhe në mos pasët prindt, ajo s’ka tager me mendue per martesë të vet, tagri asht në dorë të vllazenve a të kushrinjve. Vajza s’ka tager: a. Me zgjedhë fatin e vet; do të shkojë per*

<sup>27</sup> Zamputi në lidhje me detyrat e gruas në fis shprehet kështu: *“...në të gjitha materialet dokumentare si edhe në të gjitha njohuritë tradicionale që kemi për jetën e shoqnisë sonë malësore në të kaluemen, se gruaja përjashtohet nga jeta publike e fisit dhe konsiderohet në funksionet e saja kryesore, vetëm krahas pune dhe nanë.”* I. Zamputi, *“Pozita shoqnore...”*, f. 103.

<sup>28</sup> *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, përmbledhur nga A. Shtjefen Gjeçov, Shkodër: Shtypshkronja Françeskane, 1933, f. 8-9; Në lidhje me detyrën parësore të gruas Nopça shprehet kështu: *“Detyra kryesore e gruas është të lindë djem dhe, meqenëse në Shqipëri fuqia mbrojtëse dhe ndikimi i familjes mbështeten në numrin e meshkujve, është e natyrshme që në Shqipëri, më tepër se në çdo vend tjetër, dëshirohet lindja e djemve. Një grua, pra, që lind vetëm vajza, quhet bashkëshorte e keqe dhe disa dispozita rregullojnë gjendjen e saj. Në shek. XVII në Shqipëri ishte zakon të vinin kurorë pasi lindte djalë. Ky zakon u hoq më 1703 nga koncili kishtar i Shqipërisë; ishte një nga detyrat e këtij koncili.”* F. Nopça, *Fiset e malësisë...*, f. 386-388; Gjithashtu shih: I. Zamputi, *“Pozita shoqnore...”*, f. 101-102.

<sup>29</sup> *“Kontrata e blerjes, që fillon me fejesën, merr fund me dorëzimin ceremonial të këstit të fundit të çmimit të blerjes së nuses dhe në këtë mënyrë kjo bëhet pronë e blerësit... Me anën e ceremonisë së martesës nusja hyn në pronësinë e ngushtë të bashkëshortit.”* F. Nopça, *Fiset e malësisë...*, f. 292.

atë, për të cilin t'a fejojn; b. M'u perzie në shkuesi as në fejesë; c. As në këpucë as në petka”.<sup>30</sup>

Me kryerjen e aktit të martesës, gruaja bëhet “pronë” e burrit dhe e ka për detyrë të jetë e bindur kundrejt tij. Nga vëzhgimet e bëra nga udhëtarë të huaj kryesisht në Shqipërinë e Veriut e cila funksiononte në bazë të kanunit vërehet se në disa raste ai ka të drejtë edhe ta godasë gruan e vet. Madje, Nopça shprehet se në rast tradhtie shikohet normale edhe vrasja e saj.<sup>31</sup> Po në lidhje me martesën, kanuni thekson se familja e vajzës nuk ka obligime në përgatitjen e pajit ose në organizime të ngjashme. Kjo, për faktin se sipas konceptit të kanunit vajza, “qysh në djep konsiderohet dhe rritet për shtëpinë e burrit”.<sup>32</sup> Pra, nga familja e vet ajo nuk trashëgon ndonjë pasuri: “Grueja shqyptare farë trashigimit s'ka te prindja, as më plang, as në shpi, kanuja e xen gruen si një tepricë në shpi. Prindja s'mendon për pajë as per kurrnji send per vajzë të vet; aj, qi e xen do t'i baje kujdesin. Prindja e djalit, qi xun vajzën do të mendojn per gjith shka duhet per martesë të saj.”<sup>33</sup>

Në kanun, gjithashtu ka dispozita të qarta në lidhje me mënyrën e përgatitjes së dasmës, pozitën dhe detyrat e nuses në shtëpinë e burrit, të drejtat e grave të cilat mbeten vejusha, të atyre që vdesin në shtëpinë e burrit në një kohë të shkurtër pas martesë etj.<sup>34</sup> Sa për trashëgiminë, mund të thuhet se kanuni nuk e favorizon gruan duke ia mohuar asaj të drejtën e të trashëguarit, duke njohur për trashëgues vetëm djalin, e jo vajzën.<sup>35</sup> Konkretisht, në kanun në lidhje me aspektin e të trashëguarit të gruas thuhet kështu: “Me dalë fare mashkullimi i një shpije e njëqind bija me pasë dalë aso dere, s'kan tager me u perzie në trashigim të prindës as këto, as bijt e tyne.... Me mbetë plangu në bija, kushrini ma i ngiati, a

<sup>30</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit..., f. 11.

<sup>31</sup> F. Nopça, *Fiset e malësisë...*, f. 385.

<sup>32</sup> I. Zamputi, “Pozita shoqnore...”, f. 103.

<sup>33</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit..., f. 14-15; Sipas kësaj, gruaja nuk ka të drejtë trashëgimie dhe çdo gjëje tjetër që ka lidhje me forcën ekonomike të shoqërisë as te shpia e prindërve e as te ajo e burrit. Ajo ka të drejtë të përfitojë nga shtëpia ku jeton vetëm për nevojat jetike siç janë të ushqyerit e të veshurit (Grueja s'hijn në pjesë të të damit, posë për bukë të gojës –në të gjitha sendet qi hahen e pihen-). Shih: I. Zamputi, “Pozita shoqnore...”, f. 103-104.

<sup>34</sup> F. Nopça, *Fiset e malësisë...*, f. 391.

<sup>35</sup> Po aty, f. 453; I. Zamputi, “Pozita shoqnore...”, f. 103.

*shkon te ato, a i merr në shpi të vet, e aty e m'at hov merr sundimin mbi gja, pasuni e pronë.*<sup>36</sup>

*b. Disa të dhëna mbi pozitën dhe të drejtat e gruas në shoqërinë shqiptare nën sundimin osman*

Periudha osmane zë një vend të rëndësishëm në historinë e Shqipërisë. Kjo, për faktin se koha në fjalë përbën pjesën më të gjatë dhe më të dokumentuar të kombit shqiptar. Dokumentacioni i periudhës osmane që gjendet pranë Arkivit Qendror të Shtetit mbart qindra mijëra dokumente të cilat kanë të dhëna të rëndësishme në lidhje me shoqërinë, kulturën, politikën dhe të gjithë komponentët e tjerë të jetës në Shqipëri gjatë kësaj kohe. Për pasojë, edhe analizimi i të dhënave në fjalë sidomos në çështjet administrative, burokratike e ushtarake duhet parë në kontekstin perandorak. Një element tjetër që duhet të kihet parasysh është dhe përbërja teokratike e shtetit osman, gjë që e bën të nevojshëm kuptimin e traditës juridike islame në analizimin dhe interpretimin e fenomeneve, politikave dhe qasjeve të ndryshme të perandorisë me popujt që e formonin atë. Në rastin konkret, edhe studimi i pozitës dhe të drejtave të gruas shqiptare gjatë periudhës së sundimit osman duhet analizuar në këtë kontekst.

Për sa i përket studimeve në lidhje me rolin e gruas në Perandorinë Osmane, mund të thuhet se ka disa punime, që janë bërë në këtë fushë. Të dhënat më të hershme në lidhje me gruan osmane hasen kryesisht në kronikat e udhëtarëve perëndimorë të shek. XIX.<sup>37</sup> Në këto vepra kryesisht jepen të dhëna mbi jetën në harem, gratë sulltanesh, princeshat dhe femrat të cilat i përkisnin sferës së lartë të shoqërisë edhe elementë të

<sup>36</sup> *Kanuni i Lekë Dugagjinit...*, f. 26.

<sup>37</sup> Për më shumë të dhëna mbi disa udhëtarë të rëndësishëm që vizituan gjeografinë osmane gjatë periudhës në fjalë dhe disa nga kronikat ose ditarët e tyre në lidhje me elementë të ndryshëm të jetës shoqërore, ekonomike e kulturore shih: Abdurrahman Kurt, "Osmanlı'da Kadının Sosyo-Ekonomik Konumu", *Osmanlı*, C. 5, ed. Gülen Eren, Ankara: 1999, f. 434; Një libër me rëndësi të veçantë në lidhje me jetën e gruas osmane janë edhe letrat me kujtime të gruas së ambasadorit anglez pranë shtetit osman në gjysmën e parë të shek. XVIII. Në këtë punim trajtohen me syrin e një gruaje aristokrate perëndimore aspekte të ndryshme të jetës në Orient, dhe gruas lindore në veçanti. Për më shumë shih: Mary Wortley Montague, *Ltrat e Zonjës Mary Wortley Montague*, Përkth. Arjol Guni, Tiranë: Logos-A, 2014.

tjera të femrës orientale.<sup>38</sup> Ndërsa në aspektin shkencor e studimor, hulumtimet në lidhje me jetën e gruas në Perandorinë Osmane hasen kryesisht pas gjysmës së dytë të shek. XX. Ndër këta spikasin studimet e bëra nga kërkuesit Ronald Jennings dhe Haim Gerber, rezultatet dhe arritjet e të cilëve i kanë dhënë një dimension tjetër kërkimeve në këtë fushë dhe janë pikë reference për shumë studiues të periudhës në fjalë.<sup>39</sup> Po kështu, ka edhe punime të tjera të bëra në lidhje me gruan në pjesë të ndryshme të perandorisë e kryesisht në ato të Ballkanit si në Bosnje, Greqi etj.,<sup>40</sup> të cilat kanë bërë të mundur që studiuesit të krijojnë një ide të përgjithshme rreth qasjes së shtetit osman në lidhje me gruan në përgjithësi.

Duhet theksuar që për një kohë të gjatë gruaja osmane është parë si një qenie e cila ishte e zhytur në injorancë, që e kalonte kohën në shtëpi e që merrej nëpër këmbë.<sup>41</sup> Por, studimet e bëra dekadat e fundit nga studiuesit e mësipërm dhe autorë të ndryshëm nxorren në dritë detaje të tjera të cilat vënë në pah faktin që jeta e femrës në Perandorinë Osmane, veçanërisht në të drejtat që asaj i njihje ligji ishte më e rregullt. Një element tjetër që duhet patur parasysh në trajtimin e femrës osmane, konsiston në faktin që ajo na del përpara me statuse të ndryshme siç mund të jenë gruaja myslimane, jomuslimane, sulltaneshat, ato të shtresës

<sup>38</sup> Një punim i rëndësishëm dhe i pari në llojin e vet i cili ka në fokus jetën e femrës orientale, haremin dhe influencën e grave të rëndësishme siç ishin sulltaneshat, nënat e sulltanëve dhe princeshat në Perandorinë Osmane është: Leslie P. Pierce, *The Imperial Harem Women and Sovereignty in the Ottoman Empire*, Oxford: Oxford University Press, 1993.

<sup>39</sup> Ronald C. Jennings ka realizuar një studim duke u bazuar në vendimet e gjykatave të Sheriatit për gratë në qytetin e Kajserit (në Turqi) gjatë shek. XVII. (Women in Early Seventeenth Century Ottoman Juridical Records-The Sharia Court of Anatolian Kayseri). Ndërsa Haim Gerber, të cilit i jemi referuar edhe në këtë punim, ka realizuar një studim mbi gjendjen social-ekonomike të gruas në qytetin e Bursës gjatë shek. XVII-XVIII. Për më shumë shih: Haim Gerber, "Bir Osmanlı Şehri Olan Bursa'da Kadın'ın Sosyo-Ekonomik Statüsü (1600-1700)", *Selçuk Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, sy. 8, Konya: 1999; Ruth M. Roded, "Osmanlı Tarihine Cinsiyet Açısından Bakılması", *Osmanlı*, C. 5, ed. Gülen Eren, Ankara: 1999, f. 418; A. Kurt, *Osmanlı'da Kadının...*, f. 434-435; L. Pierce, *The Imperial...*, f. 271.

<sup>40</sup> Në kuadër të punimeve shkencore mbi të drejtat e grave myslimane e jomuslimane në Perandorinë Osmane veçanërisht në pjesën ballkanike duhet përmendur punimi: *Women in the Ottoman Balkans: Gender, Culture and History*, Ed. Amila Buturovic and Irvin Cemil Schick, New York: I. B. Tauris, 2007.

<sup>41</sup> H. Gerber, *Bir Osmanlı...*, f. 327; R. Roded, *Osmanlı Tarihi...*, f. 418.

së lartë, qytetare, fshatare, robëresha etj.<sup>42</sup> Të gjitha këto kishin të drejtat e tyre që u garantoheshin nga shteti dhe në bazë të të cilave gëzonin privilegjet që u njihte ligji islam siç ishin e drejta e trashëgimisë, e martesës, e divorcit etj., të cilat do të trajtohen në vijim. Duke u nisur nga fakti që ato femra të cilat i përkisnin familjes perandorake dhe atyre të shtresës së lartë, të cilat në periudha të ndryshme kanë patur influencë edhe në drejtimin e vetë perandorisë e sidomos në rivalitetin për fron<sup>43</sup>, studimet tregojnë që gruaja osmane ishte aktive në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Përveç të drejtave në familje si fejesa e martesa, por edhe trashëgimia, gruaja kishte të drejtë të menaxhonte të ardhurat e saj, të blinte ose shiste pronat, të shkonte në gjykatë për çështje të ndryshme dhe të merrte pjesë në angazhime shoqërore si ndërtimi i vakëfeve ose drejtimi i tyre. Duke qenë se edhe gjeografia shqiptare ishte pjesë e Perandorisë Osmane, të njëjtat fenomene dhe angazhime të gruas në pjesë të ndryshme të perandorisë vërehet se kanë qenë të dukshme edhe në trojet shqiptare.

Mungesa e mjaftueshme e literaturës së nevojshme për të nxjerrë një panoramë të jetës së gruas në këtë kohë, përbën një pengesë në kuptimin e gjendjes së femrës shqiptare gjatë kësaj periudhe por edhe për rolin dhe të drejtat që ajo gëzonte si në familje ashtu edhe në shoqëri. Në këtë kontekst, të vetmet burime që hedhin dritë në këtë çështje mund të konsiderohen dokumentat që gjenden pranë Arkivit Qendror të Shtetit. Kështu, vendimet e regjistrave të gjykatave të periudhës osmane japin të dhëna të rëndësishme për sa i përket jetës, aktivitetit dhe të drejtave të gruas shqiptare gjatë periudhës në fjalë. Pjesa më e madhe e regjistrave u përket shek. XVII, XVIII dhe XIX, të cilat mbartin të dhëna të mjaftueshme në lidhje me shoqërinë shqiptare gjatë kësaj periudhe. Kështu, në bazë të të dhënave arkivore të gjetura është e mundur që aktivitetin dhe të drejtat e gruas gjatë kësaj periudhe t'i ndajmë në dy kategori: në familje dhe në jetën shoqërore.

### **1. Të drejtat e gruas në familje**

Familja përbën institucionin bërthamë të shoqërisë dhe në traditën shqiptare ajo zë një vend shumë të veçantë. Duke u bazuar në ligjin

<sup>42</sup> Feriha Karadeniz, "XVI. ve XVII. Yüzyillarda Farklı Sınıflardaki Osmanlı Kadınına Genel Bir Bakış", *Osmanlı*, C. 5, ed. Gülen Eren, Ankara: 1999, f. 450.

<sup>43</sup> Fariba Zarinbeaf-Shahr, "Lale Devrinde Osmanlı Prensesleri", *Osmanlı*, C. 5, ed. Gülen Eren, Ankara: 1999, f. 428; F. Karadeniz, *XVI. ve XVII. Yüzyıllar...*, f. 451-452.

islam, mund të thuhet se edhe shteti osman i kushtoi një vëmendje të veçantë familjes duke i dhënë asaj të drejta të garantuara nga vetë institucionet perandorake. Në rastin e gruas, ligji islam dhe për pasojë dhe ai osman i dhanë të drejta që për kohën përbënin një përparim të konsiderueshëm.<sup>44</sup> Kështu, njëra ndër të drejtat themelore që i jepej femrës ishte ajo e trashëgimisë. Si mashkulli, ashtu edhe femra kishte të drejtën e pasurisë së trashëguar dhe e menaxhonte atë sipas dëshirës së saj. Ajo gëzonte të drejtën e të trashëguarit gjysmën e pjesës së mashkullit me të cilin kishte afërsi të barabartë farefisnore.<sup>45</sup> Në regjistrat e gjykatave janë të shumta aktet e trashëgimisë në të cilat theksohet që ndër përfituesit e pasurive të lëna ishin edhe femrat. Për shembull, në një dokument të vitit 1701 tregohet se zotëria me emrin Xhaferr nga Mallakastra, një funksionar i lartë në Perandorinë Osmane ishte vrarë në betejën e Nishit dhe pasuria e tij trashëgohet nga e shoqja zonja Aishe, dy djemtë Aliu dhe Ahmeti dhe vajza Hanemeja.<sup>46</sup> Po në kuadër të trashëgimisë, duhet theksuar se e drejta e përfitimit nuk ishte e njëjtë si për mashkullin ashtu edhe për femrën dhe varionte sipas rasteve dhe dispozitave që ligji islam kishte për rastet e veçanta. Për shembull, kur një burrë vdiste dhe si trashëgimtare kishte vetëm gruan e tij, ajo kishte të drejtën të merrte vetëm një katërtën e pasurisë së lënë, ndërsa pjesa tjetër i kalonte thesarit të shtetit.<sup>47</sup>

Në raste problemesh në lidhje me çështjet e trashëgimisë, gruaja kishte të drejtë të ankohej dhe të kërkonte drejtësi në instanca zyrtare siç ishte gjykata. Madje, në lidhje me këtë aspekt, në regjistrat e gjykatës së Sheriatit të Beratit vërejmë një rast të vitit 1702, që tregon më së miri mënyrën se si gruaja e kërkonte dhe e mbronte trashëgiminë që i kishte mbetur. Sipas këtij dokumenti, gruaja me emrin Emine, e shoqja e Ahmet Beut kishte problem me trashëgiminë e mbetur nga i shoqi që i kishte vdekur sepse vjehrra e saj Azizeja kishte vënë dorë mbi këtë pasuri dhe gjithashtu ushtronte edhe dhunë mbi nusen. Meqë çështja nuk është zgjidhur në instancat përkatëse, mësohet se ky ankim ka vajtur deri te Kadiasqeri i Rumelisë, i cili me anë të dokumentit në fjalë i shkruan

<sup>44</sup> H. Gerber, *Bir Osmanlı...*, f. 329; R. Roded, *Osmanlı Tarihi...*, f. 419; A. Kurt, *Osmanlı'da Kadının...*, f. 435-436.

<sup>45</sup> R. Roded, *Osmanlı Tarihi...*, f. 419.

<sup>46</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë*, (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 128, Dosja (më tej: D.) 21, fleta (më tej: fl.) 21.

<sup>47</sup> F. Karadeniz, *XVI. ve XVII. Yüzyıllar...*, f. 453.

kadiut të Beratit për zgjidhjen e kësaj çështjeje.<sup>48</sup> Rasti i sipërcituar tregon që gjatë periudhës në fjalë gruaja kishte të drejtë të hapte çështje gjyqësore dhe të kërkonte në mënyrë legale të gjitha të drejtat që i njihite asaj ligji i kohës.

Një tjetër të drejtë që gëzonte gruaja shqiptare gjatë shekujve në fjalë konsistonte dhe në aktet e fejesës dhe të martesës. Sipas kësaj, ajo kishte të drejtën e aprovimit ose jo të fejesës ose martesës me kandidatin që i propozohej. Në regjistrat e gjykatave kemi shembuj të shumtë të vajzave apo vejushave të cilat janë paraqitur përpara gjykatësit dhe kanë kërkuar “të mos u lidhet kurorë pa praninë e tyre”. Gjithashtu, ka shumë dokumenta por edhe studime të cilat tregojnë që këtë të drejtë e gëzonin edhe gratë e besimeve të tjera, si në gjeografinë shqiptare ashtu edhe në pjesë të ndryshme të perandorisë.<sup>49</sup> Për t’u vlerësuar është fakti që jo vetëm femrat që jetonin në zonat urbane ishin kaq të lira në këtë aspekt, por edhe ato që jetonin në zonat rurale ndërmerrnin nisma të tilla. Për shembull, në një dokument të vitit 1695 vajza me emrin Rabie, e bija e Mahmutit nga katundi Breshtan i Beratit paraqitet te gjykatësi dhe kërkon të mos i lidhet kurorë pa qenë ajo e pranishme.<sup>50</sup> Një dokument tjetër tregon për të krishterën e quajtur Saveta, e bija e Thanasit nga fshati Perondija, e cila paraqitet në gjykatë dhe kërkon të mos i lidhet kurorë pa lejen e saj dhe pa qenë ajo e pranishme, edhe nëse paraqiten të afërm të saj për ta martuar atë.<sup>51</sup> Në kuadër të aktit të fejesës dhe martesës, duhet theksuar se ligji islam urdhëron pagesën e një shume parash, dhurimin e një pasurie, prone ose diçka të ngjashme që dhëndrri ia dhuronte nuses para martesës (mehr). Shuma e paguar varionte sipas shtresës ekonomike e sociale të cilës i përkisnin të dy kandidatët dhe vlefte e premtuar në shumicën e rasteve shënohej në dokumentin e kurorëzimit.<sup>52</sup> Ky rregull është aplikuar në Perandorinë Osmane e si pasojë edhe në gjeografinë shqiptare. Në regjistrat e gjykatave hasim raste edhe në lidhje me këtë

<sup>48</sup> AQSH, F. 128, Dos. 21, Fl. 103.

<sup>49</sup> Sophia Laiou, “Christian Women in an Ottoman World: Interpersonal and Family Cases Brought Before the Shari’a Courts During the Seventeenth and Eighteenth Centuries (Cases Involving the Greek Community)”, *Women in the Ottoman Balkans: Gender, Culture and History*, Ed. Amila Buturovic and Irvin Cemil Schick, New York: I. B. Tauris, 2007, f. 243-244.

<sup>50</sup> AQSH, F. 128, Dos. 19, Fl. 37.

<sup>51</sup> *Po aty*, F. 128, Dos. 10, Fl. 32.

<sup>52</sup> S. Laiou, *Christian Women...*, f. 245; F. Karadeniz, *XVI. ve XVII. Yüzyıllar...*, f. 453; A. Kurt, *Osmanlı’da Kadının...*, f. 444; R. Roded, *Osmanlı Tarihi...*, f. 419.

temë. Për shembull në një dokument të vitit 1606, në gjykatën e qytetit të Elbasanit një grua paraqitet në gjykatë duke paditur të shoqin i cili i kishte premtuar asaj para martesës një ferexhe (mbulesë) si dhuratë e më pas nuk ia kishte dhuruar.<sup>53</sup> Me anë të pagesës apo dhurimit të mehrit, mendohej se femra kishte një siguri financiare e cila mbetej e saj gjatë martesës dhe që ajo kishte të drejtë ta menaxhonte sipas dëshirës dhe nevojave të veta. Në këtë kontekst, mund të thuhet se në arkiva gjenden me mijëra dokumente të këtij lloji.

Një element tjetër në kuadrin e të drejtave të gruas brenda familjes është dhe çështja e divorcit. Në raste mosmarrëveshjeje ose problemeve të ndryshme të rëndësishme brenda familjes të cilat nuk mund të zhgjidheshin me anë të ndërmjetësimeve, ajo adresohet në gjykatë për të kërkuar divorcin bashkë me të drejtat që i takonin sipas ligjit.<sup>54</sup> Nëse gjykata vendoste për ndarjen e kurorës, gruaja kishte të drejtën e përfitimit të pjesës së pasurisë nga i shoqi që i jepte gjykata asaj (nafaka). Shuma e paguar në rastet e divorcit varionte sipas pasurisë që posedonte familja dhe pagesa konsistonte në para por edhe në elementë materialë. Për shembull, në një rast divorci të vitit 1695 në qytetin e Beratit gruaja me emër Fatime përfiton nga gjykata si nafaka 2000 akçe, 6 okë vaj dhe sende të tjera.<sup>55</sup> Por, ka dhe dokumente të tjera që tregojnë për raste kur gruaja hiqte dorë me dëshirën e saj nga të drejtat që i takonin nga divorci, siç është rasti i gruas me emër Sulltane e cila deklaroi se heq dorë nga përfitimet që i jepte asaj gjykata nga shkurorëzimi me Ahmet Hasanin.<sup>56</sup>

Një aspekt tjetër në lidhje me të drejtat e gruas në jetën bashkëshortore por edhe në atë brenda familjes është dhe çështja e administrimit të pasurisë së trashëguar. Studimet e kryera të bazuara në dokumentet e kohës, tregojnë se gruaja kishte të drejtë të menaxhonte pasurinë dhe të ardhurat e saj të trashëguara nga familja e vet, të dhuruara apo fituara gjatë periudhës së martesës.<sup>57</sup> Pra, brenda jetës bashkëshortore gruaja dhe burri e kishin pasurinë e ndarë, aspekt i pranuar dhe mbrojtur ligjrisht. Kështu, mbi pasurinë apo pronën që ajo posedonte mund të kryente veprime në mënyrë të pavarur si shitje, investime, donacione

<sup>53</sup> AQS, F. 129, D. 3, fl. 50.

<sup>54</sup> A. Kurt, *Osmanlı'da Kadının...*, f. 446; S. Laiou, *Christian Women...*, f. 244.

<sup>55</sup> AQS, F. 128, D. 19, fl. 37.

<sup>56</sup> *Po aty*, F. 128, D. 9, fl. 42.

<sup>57</sup> H. Gerber, *Bir Osmanlı...*, f. 330-332; R. Roded, *Osmanlı Tarihi...*, f. 420.

mund të jepte kredi, madje ka raste kur i jepte hua edhe bashkëshortit.<sup>58</sup> Në arkiva hasen dokumenta të shumta për raste ku gratë e menaxhonin pasurinë e vet, e shisnin ose e dhuronin atë, madje në raste mosmarrëveshjeje edhe me pjesëtarët e familjes ajo kishte të drejtë ta çonte çështjen në gjykatë. Kështu, një grua nga Fanica e Beratit shet shtëpinë e saj bashkë me vreshtë për 4000 akçe<sup>59</sup>, ndërsa një grua tjetër e dhuron shtëpinë e saj<sup>60</sup>. Një zonjë tjetër me emrin Hanife nga lagja Tabakhane e Elbasanit deklaroi se shet shtëpinë bashkë me oborr për shumën e 3700 akçeve.<sup>61</sup> Gjithashtu, ka edhe raste të tjera kur gruaja ia shet ose ia dhuron bashkëshortit të saj pronën që ajo posedon. Për shembull, në një dokument të vitit 1703, mësohet se gruaja e quajtur Rabije nga një fshat i Beratit i shet të shoqit të saj një shtëpi.<sup>62</sup> Ndërsa në një dokument tjetër të vitit 1701, gruaja me emrin Fatime nga lagja Murat Çelebi e të njëjtit qytet është paraqitur në gjykatë dhe ka deklaruar se ia fal të gjithë pasurinë e saj të shoqit, Hysen Beut.<sup>63</sup>

## 2. Roli i gruas në jetën shoqërore

Dokumentet dhe studimet e bëra në lidhje me periudhën në fjalë tregojnë se përveç ambientit familjar, femra ishte e angazhuar edhe në jetën shoqërore. Ato i gjejmë të punësuar në mjedise të ndryshme tregtare, por edhe drejtuese të vetë punës së vet. Pra, atyre u jepej e drejta e ushtrimit në mënyrë të pavarur të zejtit që ushtronte (testir). Për sa i përket punësimit, studiuesi Zija Shkodra ka theksuar se shumica e femrave ishin angazhuar në zeje të ndryshme me karakter shtëpiak.<sup>64</sup> Ky fenomen vërehet më shumë në qendrat urbane siç mund të përmenden qytetet shqiptare të kohës si Elbasani, Berati, Shkodra, Prizreni, Shkupi etj. Kështu, në studimet dhe dokumentat arkivore vërehet se gra të

<sup>58</sup> Ferit Duka, *Berati në kohën osmane (shek. XVI-XVIII)*, Tiranë: Botimet Toena, 2001, f. 116; H. Gerber, *Bir Osmanli...*, f. 332.

<sup>59</sup> *AQSH*, F. 128, D. 10, fl. 2.

<sup>60</sup> *Po aty*, F. 128, D. 10, fl. 18.

<sup>61</sup> *Po aty*, F. 129, D. 2, fl. 9.

<sup>62</sup> *Po aty*, F. 128, D. 9, fl. 41.

<sup>63</sup> *Po aty*, F. 128, D. 21, fl. 29.

<sup>64</sup> Zija Shkodra, *Esnafët shqiptarë (Shek. XV-XX)*, Instituti i Historisë, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: 1973, f. 123.

ndryshme shqiptare të besimeve të ndryshme kanë qenë të punësuar në korporata të ndryshme si në pëlhura, gëzofe, esenca të ndryshme etj.<sup>65</sup>

Një ndër fushat më të rëndësishme në të cilën ishin organizuar gratë gjatë shek. XVII-XIX ishin edhe vakëfet. Kishte disa arsye që i shtynin gratë të angazhoheshin në institucionet e vakëfeve. Së pari, duke patur parasysh jetën e gruas gjatë kësaj periudhe dhe faktin që ajo nuk lëvizte shumë jashtë ambienteve familjare, vakëfet ishin institucione që nuk kërkonin daljen në terren. Së dyti, ato ishin më aktive në kryerjen e aktiviteteve të bamirësisë. Deri sot nuk janë bërë studime të mirëfillta në lidhje me numrin e grave të angazhuara në vakëfe në rang perandorak, por studimet e bëra tregojnë që në një pjesë të mirë të zonave urbane ato janë marrë më shumë se burrat në këto aktivitete.<sup>66</sup> Në lidhje me Shqipërinë, nuk ka studime që tregojnë numrin e grave të angazhuara në institucionet e bamirësisë siç ishin vakëfet. Por, dokumentet arkivore dhe regjistrat gjykatave tregojnë për një numër të konsiderueshëm grash, të cilat kishin ndërtuar vakëfe, kishin dhënë donacione apo kishin punuar edhe vetë në këto institucione. Madje, kemi edhe raste kur gruan e shohim si administratore (mutevelli) vakëfi, aspekt i cili vërehet rrallë në Perandorinë Osmane ku shumicën dërrmuese të drejtuesve të vakëfeve e përbënin meshkujt. Konkretisht, në një dokument të vitit 1703 bëhet fjalë për një zonjë të quajtur Kadrije, e cila emërohet administratore e një vakëfi të një xhamie në qytetin e Beratit.<sup>67</sup> Po ashtu, dokumentet tregojnë edhe për zonjën Rukije në qytetin e Elbasanit e cila është kujdestarja e vakëfit të saj.<sup>68</sup>

Në kuadër të kontributit dhe angazhimit të gruas në jetën shoqërore shqiptare gjatë periudhës së sundimit osman, vlen të përmendet dhe aktivizimi i tyre në përmirësimin e infrastrukturës së qyteteve. Ky angazhim, gjithashtu, duhet trajtuar në kuadër të vakëfeve apo veprave me karakter bamirësie të cilat u përmendën më sipër. Ka shumë dokumenta dhe të dhëna që tregojnë për ndërtimin e çezmave, urave,

<sup>65</sup> Veçanërisht në qytetin e Elbasanit vërehen shumë dokumenta që tregojnë për gra të cilat kanë fituar të drejtën e ushtrimit në mënyrë të pavarur të zanatit që ato zotëronin, ose kanë trashëguar zanatin që mund të ketë patur prindi i vet. Vlen të theksohet që një pjesë e mirë e këtyre grave vërehet që u përkasin edhe besimeve të tjera, pra jo-myslimane. Për më shumë shih: Z. Shkodra, *Esnafët shqiptarë...*, f. 123-124.

<sup>66</sup> A. Kurt, *Osmanlı'da Kadının...*, f. 440.

<sup>67</sup> *AQSH*, F. 128, D. 9, fl. 28.

<sup>68</sup> *Po aty*, F. 129, D. 3, fl. 67.

shkollave, kervansarajeve dhe institucioneve të ngjashme nga ana e grave. Studiuesit shprehen se gjatë shek. XV-XIX ka shumë ura siç mund të përmendet ajo e Zonjës në Labovë, e Cines në Rrëzomë, e Vashës në Gur të Bardhë etj., ndërtimi i të cilave është financuar nga gra të ndryshme.<sup>69</sup>

### **Përfundim**

Siç u pa edhe më sipër, në këtë studim jemi munduar të krijojmë një panoramë të gjendjes së gruas shqiptare gjatë periudhës së Mesjetës, duke u përqendruar më së shumti në shek. XVII-XVIII. Për punimin, janë përdorur çështjet e shqyrtuara dhe vendimet që kanë dalë në lidhje me to në regjistrat e gjykatave të shariatit të qyteteve të ndryshme. Nga sa u trajtua më sipër, dokumentat arkivore tregojnë që edhe pse jetonte në një periudhë të vështirë gruaja shqiptare gëzonte disa të drejta themelore si e drejta e të trashëguarit, e fejesës dhe martesës, e drejta e pasurisë dhe e menaxhimit të saj, të drejtën e aplikimit në gjykata për të drejtat e saj etj. Gjithashtu, dokumentat tregojnë që ajo ishte e angazhuar edhe jashtë shtëpisë si të marrurit me profesione të ndryshme ashtu edhe aktivizimi në dobi të shoqërisë me anë të vakëfeve apo institucioneve të ngjashme.

Të dhënat e mësipërme, tregojnë që gruaja shqiptare gjatë kësaj periudhe gëzoi disa të drejta që për shoqërinë e kohës ishin një arritje e konsiderueshme. Por, përveç të drejtave të përmendura gruaja shqiptare haste dhe probleme e vështirësi që kishin lidhje me kushtet ekonomike të kohës, vajtjen në luftëra të burrave etj. Një fenomen tjetër negativ në lidhje me gruan i cili është evident duke nisur që nga fundi i shek. XVIII, është dhe dhënia e vajzave në moshë të mitur si shërbëtoresh pranë familjeve të pasura për shuma qesharake. Këto dhe shumë elementë të cilat nuk kemi mundur t'i përfshijmë në këtë punim e bëjnë të nevojshëm shumimin e studimeve në lidhje me gruan, me qëllim për të nxjerrë në pah rolin dhe pozitën e gruas shqiptare gjatë periudhës në fjalë.

---

<sup>69</sup> Valter Shtylla, *Rrugët dhe urat e vjetra në Shqipëri*, Tiranë: Toena, 1997, f. 210; Z. Shkodra, *Esnafët shqiptarë...*, f. 164-165.

*S u m m a r y*SOME BRIEF INFORMATION ON THE ALBANIAN WOMEN  
DURING THE XVII-XVIII CENTURIES

This article aims to give some information about several aspects regarding the life of Albanian women during 17-18<sup>th</sup> centuries. The arguments are based on interpersonal and family cases brought before the Shari 'a courts. The examples given in the article were taken from court registers of main Albanian cities as Berat, Elbasan, Korça and Shkodra. As seen from above records, the Albanian women of Ottoman period had some juridical rights in some aspects such bequest, marriage, divorce, managing her properties and earnings and bringing before court cases regarding to her rights. Also, the data shows that she was very active outside the home like working or giving her contribution to the society through waqf's or similar humanitarian organizations.

Main part of the court registers contains data on basic elements of daily life, as marriage or divorce registers. It is important to note that a part of non Muslim's used to avoid their communal courts and go to the Ottoman ones. These registers also, contain many mixed marriages registers that is a very important data for the researchers of this period. A lot of applies to the courts also, consisted in the cases of bequest. And, the other cases regard to the role of women in society such donation registers, legalization of waqfs or other social subjects. The results show that the Albanian women of 17-18<sup>th</sup> centuries faced many problems caused by the social, economic and cultural conditions, but, also she had some rights that were given to her by the Ottoman law.

